# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**
www.legjislacionishqiptar.gov.al

**Nr.100 2 gusht 2007**

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.431, datë 11.7.2007 | Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Gramsh, të qarkut të Elbasanit............................ | 2843 |
| Vendim i KM nr.432, datë 13.7.2007 | Për klasifikimin e funksioneve, trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit............. | 2843 |
| Vendim i KM nr.433, datë 13.7.2007 | Për disa ndryshime në vendimin nr.317, datë 30.5.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të shtëpisë së pushimit të Ministrisë së Brendshme, Durrës”...................................................... | 2847 |
| Vendim i KM nr.434, datë 13.7.2007 | Për disa ndryshime në vendimin nr.551, datë 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, e për përcaktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, të ndryshuar.................................. | 2848 |
| Vendim i KM nr.435, datë 13.7.2007 | Për një ndryshim në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë, në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar................... | 2852 |
| Vendim i KM nr.463, datë 18.7.2007 | Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentraleve në kaskadën e lumit Devoll, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë………………………………………………………….. | 2862 |

**VENDIM**
**Nr.431, datë 11.7.2007**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË GRAMSH, TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të bashkisë Gramsh, të qarkut të Elbasanit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 80 (tetëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 499 (katërqind e nëntëdhjetë e nëntë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Gramshit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.432, datë 13.7.2007**

**PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË PËR PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 e 22 të ligjit nr. 9357, datë 17.3.2005 "Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit", të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit, sipas detyrave që kryejnë në shërbim dhe funksioneve organike që kanë, klasifikohen në 4 nivele, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Struktura dhe nivelet e pagave, sipas niveleve të klasifikimit, për punonjësit e Shërbimit Informativ të Shtetit janë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Paga bazë mujore për klasë, sipas çdo niveli klasifikimi, është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Shtesa për gradë, sipas çdo niveli klasifikimi, është sipas kolonës 6 të lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Punonjësve të Shërbimit Informativ të Shtetit, sipas çdo niveli klasifikimi, u jepet shtesë për vjetërsi në punë, në masën 1 për qind, mbi pagën bazë mujore për klasë, por jo më shumë se 25 për qind, sipas kolonës 5 të lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Për llogaritjen e kësaj shtese njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.

6. Të drejtën e pagës e gëzojnë edhe kursantët për periudhën, që vazhdojnë kursin e kualifikimit, pranë Institutit të Shërbimit Informativ të Shtetit. Paga e kursantit është sa paga minimale e inspektorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.

7. Punonjësve të Shërbimit Informativ të Shtetit, që marrin pagën sipas niveleve të klasifikimit të këtij vendimi, u jepet shtesë për vështirësi vendi dhe zone, në masën deri në 60 për qind të pagës bazë mujore.

Masa për çdo shtesë, vendi i punës, vështirësia e funksionit, si dhe kriteret për përfitimin e shtesës mbi pagë, përcaktohen me akt normativ të drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.

8. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore, të planifikuara për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave, për këtë vit.

9. Ngarkohet Shërbimi Informativ i Shtetit të nxjerrë aktet normative përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

10. Vendimet nr.56, datë 27.2.1992 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve në Shërbimin Informativ Kombëtar", të ndryshuar, dhe nr.43, datë 7.2.2002 "Për pagesën e kandidatëve, që punësohen në Shërbimin Informativ Shtetëror" të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2007.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LIDHJA NR.1

KLASIFIKIMI I FUNKSIONEVE NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT

Funksionet në Shërbimin Informativ të Shtetit klasifikohen në 4 nivele:

I. Punonjës mbështetës;
II. Punonjës të nivelit zbatues;
III. Punonjës të nivelit të mesëm drejtues;
IV. Punonjës të nivelit të lartë drejtues.

Niveli I: Merret me zbatimin e detyrave në këtë nivel, duke u bazuar në eksperiencën profesionale të fushës dhe në njohuritë e specialitetit.

a) Ndihmës inspektor Klasa I.1-I.4
b) Inspektor baze Klasa I.5

Niveli II: Ka përgjegjësinë për punën konkrete, sipas drejtimeve të miratuara, bën të mundur koordinimin e mendimit dhe opsioneve të reja në një fushë të caktuar, përgatitjen e materialeve përfundimtare, të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues, sipas hierarkisë administrative.

a) Inspektor në aparatin qendror Klasa II.1
Kryetar dege në bazë
Përgjegjes seksioni në Tiranë
b) Kryetar dege në drejtorinë e Tiranës Klasa II.2
Përgjegjës sektori në aparatin qendror
Shef baze në aparatin qendor
Inspektor në aparatin qendror.

Niveli III: Ka përgjegjësinë e programimit të punëve, menaxhimit dhe zbatimit të tyre, për drejtimet që mbulon, në përputhje me prioritetet e Shërbimit Informativ të Shtetit, të cilat duhen miratuar dhe aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë i njësisë strukturore sipas drejtimeve përkatëse.

a) Kryetar dege në aparatin qendror Klasa III.1
Kryetar dege autonome në aparatin qendor
Përgjegjës seksioni në aparatin qendror
Shef laboratori në aparatin qendror
lnspektor në aparatin qendror.
b) Drejtor në drejtoritë e bazës Klasa III.2
Zv/drejtor në aparatin qendror
Zv/drejtor në drejtorinë e Tiranës.

Niveli IV: Ka përgjegjësi për menaxhimin e punës në Shërbimin Informativ të Shtetit, përcaktimin e strategjisë dhe hartimin e politikave të përgjithshme në fushat që mbulon njësia e tij strukturore, përdorimin me efiçencë të të gjitha burimeve financiare, njerëzore etj., me qëllim arritjen e rezultateve të përcaktuara, si dhe dhënien e produktit përfundimtar, Drejtorit apo Zv/Drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit.

a) Shef Kabineti Klasa IV.1
Këshilltar
Drejtor Drejtorie në aparatin qendror
Drejtor në drejtorinë e Tiranës.

b) Drejtor departamenti Klasa IV.2.

**Lidhja nr.2**

**Struktura dhe nivelet e pagave sipas klasifikimit të funksioneve, për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit**

| Nivelet e klasifikimit | Klasifikimi i punonjësve sipas niveleve | Klasa për çdo nivel klasifikimi | Paga bazë mujore për klasë në lekë | Shtesa për Vjetërsi në % | Shtesa për gradë në % |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| I | Punonjës mbështetës | I.1 | 16800 | 1% | 2% |
| | | I.2 | 18300 | 1% | 2% |
| | | I.3 | 22700 | 1% | 3% |
| | | I.4 | 24500 | 1% | 5% |
| | | I.5 | 30460 | 1% | 6% |
| II | Punonjes të nivelit zbatues | II.1 | 33560 | 1% | 8% |
| | | II.2 | 36560 | 1% | 12% |
| III | Punonjës të nivelit të mesëm drejtues | III.1 | 40560 | 1% | 14% |
| | | III.2 | 46560 | 1% | 16% |
| IV | Punonjës të nivelit të lartë drejtues | IV.1 | 51500 | 1% | 20% |
| | | IV.2 | 61000 | 1% | 20% |
| Jashtë klasifikimit | Inspektor i Përgjithshëm në Sh. I. Sh | | 121000 | 0% | 0% |

**VENDIM**
**Nr.433, datë 13.7.2007**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 317, DATË 30.5.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË SHTËPISË SË PUSHIMIT TË MINISTRISË SË BRENDSHME, DURRËS"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.317, datë 30.5.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2, e përmendur në pikën 6, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave, sipas ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**LIDHJA NR. 1**

**Struktura dhe nivelet e pagave për pozicionet "Specialist", "Përgjegjës Sektori" dhe "Drejtor", në Shtëpinë e Pushimit të Ministrisë së Brendshme, Durrës**

| | PAGA MUJORE | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| EMERTIMI | KATEGORIA | PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË) | | | SHTESA E POZICIONIT |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 |
| | | Paga e Grupit (PG) lekë | Shtesa Vjetore për Vjetërsi (SHV) përqindje | Shtesa për Kualifikim (SHK) lekë | Shtesa për Pozicion (SHP) lekë |
| Drejtor | III-a | 10.050 | 2% | 0 | 65.000 |
| Përgjegjës sektori. | IV-a | 10.050 | 2% | 0 | 37.450 |
| Specialist. | IV-b | 10.050 | 2% | 0 | 25.850 |

**LIDHJA NR. 2**

| Nr. | Pozicioni | Paga bazë mujore (lekë) | Shtesë për kushte pune (lekë/muaj) |
|---|---|---|---|
| 1. | Përgjegjës (shërbimi i ushqimit dhe restorantit). | 38.500 | 5.000 |
| 2. | Përgjegjës (gjelbërimi, aktivite të tjera ndihmëse). | 30.000 | |
| 3. | Kuzhinier. | 24.500 | 5.000 |
| 4. | Banakier. | 24.500 | |
| 5. | Administrues hoteli. | 24.500 | 5.000 |
| 6. | Ndihmëskuzhinier. | 22.300 | 3.000 |
| 7. | Llogaritar.<br>Kamarier.<br>Recepsionist.<br>Mekanik.<br>Shofer i titullarit.<br>Magazinier. | 18.800 | |
| 8. | Elektriçist.<br>Hidraulik. | 18.000 | 3.000 |
| 9. | Marangoz.<br>Bojaxhi. | 18.000 | 2.000 |
| 10. | Punëtor (hoteli).<br>Punëtor (gjelbërimi). | 17.300 | |
| 11. | Punëtor (kuzhine).<br>Punëtor (restoranti). | 16.800 | |
| 12. | Punëtor (lavanteri) | 16.000 | |

## VENDIM
## Nr.434, datë 13.7.2007

## PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 551, DATË 7.11.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE DHE GRUPIMIN E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE, E PËR PËRCAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", të nenit 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të neneve 32 e 54 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.551, datë 7.11.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2, e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr.3, e përmendur në pikën 3, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) Pika 4/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4/1. Paga e grupit, (kolona 2), për nëpunësit që kanë kryer vitet e plota të studimit të shkollës së lartë, por që nuk kanë mundur të mbrojnë diplomën, të jetë 9 000 (nëntë mijë) lekë".

d) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Nivelet e pagave për funksionet e mëposhtme të jenë:

a) Për Bashkinë e Tiranës:

| | |
|---|---|
| - Kryetari | 119 000 – 162 850 lekë |
| - Nënkryetari | 79 000 – 128 000 lekë. |

b) Për njësitë e qeverisjes vendore, me më tepër se 50 000 banorë:

| | |
|---|---|
| - Kryetari | 58 000 – 110 000 lekë |
| - Nënkryetari | 27 000 – 83 000 lekë. |

c) Për njësitë e qeverisjes vendore, me 20 001 – 50 000 banorë:

| | |
|---|---|
| - Kryetari | 42 000 – 88 000 lekë |
| - Nënkryetari | 25 850 – 74 000 lekë. |

ç) Për njësitë e qeverisjes vendore, me 5 001 – 20 000 banorë:

| | |
|---|---|
| - Kryetari | 27 000 – 74 000 lekë |
| - Nënkryetari | 22 000 – 63 000 lekë. |

d) Për njësitë e qeverisjes vendore, me më pak se 5 000 banorë:

| | |
|---|---|
| - Kryetari | 22 000 – 49 000 lekë |
| - Nënkryetari | 21 000 – 37 450 lekë. |

dh) Për këshillin e qarkut:

| | |
|---|---|
| - Kryetari | 80 000 – 122 000 lekë |
| - Nënkryetari | 50 000 – 83 000 lekë. |

e) Për funksionin e Sekretarit:

- Sekretari i kryetarit të Bashkisë së Tiranës - kategoria IV-a (lidhja nr.1);
- Sekretari i kryetarit të bashkive të tjera – kategoria IV-b (lidhja nr.2);
- Sekretari i kryetarit të këshillit të qarkut të Tiranës – kategoria IV-b (lidhja nr.3).

dh) Pika 15 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"15. Pagat e punonjësve, që kanë funksione në shërbimin civil, por që nuk kanë arsimin e lartë, caktohen nga këshilli përkatës, në kufirin maksimal deri në 30 000 lekë.".

e) Pika 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"16. Pagat e punonjësve të tjerë (që nuk janë nëpunës civilë) të njësive të qeverisjes vendore caktohen nga këshilli përkatës, në kufirin maksimal, deri në 25 000 lekë.".

2. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**LIDHJA NR 1**

**Nivelet e pagave per nepunesit civile ne Bashkine e Tiranes**

| | | PAGA MUJORE (LEKE) | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| KLASA | KATEGORITE | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT |
| | *1* | *2* | *3* | *4* | *5* |
| | | Paga e grupit | Shtesa per Vjetersi | Shtesa per Kualifikim | Shtesa per Pozicion |
| | | | | | |
| I | I-b | 10.050 | 2% | 0 | Nga 60.000 deri 110.900 |
| II | II-a | 10.050 | 2% | 0 | Nga 60.000 deri 100.500 |
| | II-b | 10.050 | 2% | 0 | Nga 50.000 deri 84.000 |
| III | III-a | 10.050 | 2% | 0 | Nga 25.000 deri 65.000 |
| | III-b | 10.050 | 2% | 0 | Nga 20.000 deri 49.000 |
| IV | IV-a | 10.050 | 2% | 0 | Nga 15.000 deri 37.450 |
| | IV-b | 10.050 | 2% | 0 | Nga 17.000 deri 25.850 |

**LIDHJA NR 2**

**Nivelet e pagave per nepunesit civile ne bashkite e tjera, njesite bashkiake te Tiranes dhe nepunesit e komunave**

| | | PAGA MUJORE (LEKE) | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **KLASA** | **KATEGORI TE** | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | | |
| | | | | | **Njesi te qeverisjes vendore me mbi 50000 banore** | **Njesi te qeverisjes vendore me 20001-50000 banore** | **Njesi te qeverisjes vendore me 5001-20000 banore** | **Njesi te qeverisjes vendore me me pak se 5000 banore** |
| | *1* | *2* | *3* | *4* | *5* | *6* | *7* | *8* |
| | | Paga e grupit | Shtesa per Vjetersi | Shtesa per Kualifikim | Shtesa per Pozicion | Shtesa per Pozicion | Shtesa per Pozicion | Shtesa per Pozicion |
| | | | | | | | | |
| I | I-b | 10.050 | 2% | 0 | Nga 16.800 deri 50.000 | Nga 15.000 deri 40.000 | Nga 14.000 deri 27.000 | Nga 13.000 deri 22.000 |
| II | II-a | - | - | - | - | - | - | - |
| | II-b | 10.050 | 2% | 0 | Nga 14.500 deri 40.000 | Nga 14.500 deri 31.000 | Nga 13.000 deri 26.000 | - |
| III | III-a | - | - | - | - | - | - | - |
| | III-b | 10.050 | 2% | 0 | Nga 14.500 deri 31.000 | Nga 14.500 deri 27.000 | Nga 13.000 deri 21.000 | Nga 10.000 deri 18.000 |
| IV | IV-a | 10.050 | 2% | 0 | Nga 7.000 deri 21.000 | Nga 7.000 deri 21.000 | Nga 6.000 deri 19.000 | Nga 6.000 deri 15.000 |
| | IV-b | 10.050 | 2% | 0 | Nga 7.000 deri 18.000 | Nga 7.000 deri 15.000 | - | - |

**Shenim:** Këshilli i bashkisë dhe komunës në përcaktimin e shtesës në pagë për pozicion, sipas ndarjes në njësi vendore, bazohet në numrin e banorëve të Regjistrit të Gjendjes Civile, në fillim të vitit kalendarik.

**Lidhja nr. 3**

**Nivelet e pagave per nepunesit civile ne Keshillin e Qarkut**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA MUJORE (LEKE)** | | | |
| **KLASA** | **KATEGORITE** | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** |
| | *1* | *2* | *3* | *4* | *5* |
| | | Paga e grupit | Shtesa per Vjetersi | Shtesa per Kualifikim | Shtesa per Pozicion |
| | | | | | |
| I | I-b | 10.050 | 2% | 0 | Nga 30.000 deri 60.000 |
| II | II-a | - | - | - | - |
| | II-b | 10.050 | 2% | 0 | Nga 15.000 deri 45.000 |
| III | III-a | - | - | - | - |
| | III-b | 10.050 | 2% | 0 | Nga 14.500 deri 31.000 |
| IV | IV-a | 10.050 | 2% | 0 | Nga 7.000 deri 23.000 |
| | IV-b | 10.050 | 2% | 0 | Nga 7.000 deri 18.000 |

**VENDIM**
**Nr.435, datë 13.7.2007**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 306, DATË 27.6.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 (kreret 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9, 1.10.) të vendimit nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të planifikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**LIDHJA 1**
**(Kreu 1.1)**

**Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, Spitali Universitar Obsetrik Gjinekologjik nr 1, nr 2 Tirane, Spitali Universitar i Sëmundjeve të Mushkërive "Shefqet Ndroqi" Tiranë, Klinika Stomatologjike Universitare Tiranë, Spitali Ushtarak Qendror Universitar Tiranë.**

| | | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | EMERTIMI | Paga e Grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për Kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) | Shtesa për kushte pune (SHKP) | Totali |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| 1 | Drejtor<br>-QSU "Nënë Tereza" Tiranë<br>-Spitali Universitar Obsetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë" Tiranë<br>Spitali Universitar Obsetrik Gjinekologjik "Koço Glozheni" Tiranë<br>-Spitali i Sëmundjeve të Mushkerisë "Shefqet Ndroqi" Tiranë | 10050 | 2% | 0 | 84000 | | Nga..deri ...Leke |
| 2 | Drejtor<br>-Klinika Stomatologjike Universitare Tiranë | 10050 | 2% | 0 | 55000 | | Nga..deri ...Leke |
| 3 | Zëvendës drejtor | 10050 | 2% | 0 | 44500 | | Nga..deri ...Leke |
| 4 | Shef Shërbimi | 10050 | 2% | 0 | 37400 | | Nga..deri ...Leke |
| 5 | Shef reparti/klinike (kirurgji,urgjencë etj)<br>Shef i qendrës së gruas<br>Shef i sektorit biomedikal | 10050 | 2% | 0 | 35300 | | Nga..deri ...Leke |
| 6 | Shef reparti/klinike reanimacioni | 10050 | 2% | 0 | 35300 | 1100 | Nga..deri ...Leke |
| 7 | Shef reparti/klinike psikiatrie | 10050 | 2% | 0 | 35300 | 5000 | Nga..deri ...Leke |
| 8 | Shef i laboratorit klinik biokimik<br>Shef reparti kimioterapi<br>Shef laboratori | 10050 | 2% | 0 | 35300 | 2200 | Nga..deri ...Leke |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shef I qendrës së diagnozës molekulare | | | | | | |
| 9 | Shef reparti rezatimi<br>Shef reparti i kyrisë | 10050 | 2% | 0 | 35300 | 4600 | Nga..deri ...Leke |
| 10 | Shef kabineti<br>Shef I qendrës së protezimit | 10050 | 2% | 0 | 31250 | | Nga..deri ...Leke |
| 11 | Shef sektori<br>Shef farmacie në solucionet e injektueshme<br>Biokimist në solucionet e injektueshme<br>Inxhinier biomedikal<br>Inxhinier i sistemeve të ngrohjes<br>Inxhinier hemodialize | 10050 | 2% | 0 | 27200 | | Nga..deri ...Leke |
| 12 | Mjek<br>Stomatolog<br>Biolog,kimist,fizikant në preparatori<br>Mikrobiolog,parazitolog,virolog, mykolog<br>Përgjegjës qendre DDD<br>Specialist fizkulture (fizioterapi neurologji)<br>Kryellogaritar<br>Revizor | 10050 | 2% | 0 | 23000 | | Nga..deri ...Leke |
| 13 | Mjek kirurg (specialitete kirurgjikale)<br>Mjek onkolog<br>Mjek fizioeterapevt<br>Mjek obseter gjinekolog<br>Mjek pneumoftiziatër | 10050 | 2% | 0 | 23000 | 1100 | Nga..deri ...Leke |
| 14 | Mjek radilolog<br>Toksikolog, kimist,në laboratorin toksikologjik<br>Kimist në laboratorin biokimik<br>Fizikant në laboratorin biokimik<br>Biolog në laboratorin biokimik | 10050 | 2% | 0 | 23000 | 1600 | Nga..deri ...Leke |
| 15 | Mjek kimioterapeut<br>Mjek hematolog<br>Mjek infeksionist<br>Mjek në pranim urgjence<br>Mjek në njësinë nozokomiale<br>Mjek laboratori<br>Mjek histopatolog<br>Mjek në shërbimin e gjakut | 10050 | 2% | 0 | 23000 | 2000 | Nga..deri ...Leke |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 16 | Mjek në inspektoriatin sanitar<br>Inspektor sanitar<br>Epidemilog<br>Farmacist | 10050 | 2% | 0 | 23000 | 2500 | Nga..deri<br>...Leke |
| 17 | Farmacist në laboratorin toksikologjik<br>Mjek laboratori izotopik<br>Fizikant,kimist laboratori izotopik<br>Mjek në hemodinamikë<br>Fizikant në higjenë dhe epidemilogji.<br>Inxh kimist në shërbimin e higjenës në SUQU.<br>Biokimist në shërbimin e mbrojtjes nukleare biokimike në SUQU | 10050 | 2% | 0 | 23000 | 2800 | Nga..deri<br>...Leke |
| 18 | Mjek anatomopatolog<br>Mjek anestezist, reanimator<br>Mjek në pavionin e rezatimit<br>Mjek në pavionin e kyrisë<br>Specialist në qendrën e diagnozës molekulare<br>Fizikant kobalti | 10050 | 2% | 0 | 23000 | 3700 | Nga..deri<br>...Leke |
| 19 | Mjek , psikolgë , punonjës socialë që punojnë në psikatri | 10050 | 2% | 0 | 23000 | 5000 | Nga..deri<br>...Leke |
| 20 | Specialist i lartë | 10050 | 2% | 0 | 21900 | | Nga..deri<br>...Leke |

**LIDHJA 1**
**(Kreu 1.2)**

**Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe, Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Parësor, Autoritetin Shëndetësor Rajonal të Tiranës**

| | | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | EMERTIMI | Paga e Grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për Kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) | Shtesa për kushte pune (SHKP) | Totali |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| 1 | Drejtor dhe Kryeinspektor sanitar<br>Drejtor ekzekutiv | 10050 | 2% | | 55000 | 9000 | Nga..deri ...Leke |
| 2 | Drejtor | 10050 | 2% | | 38500 | | Nga..deri ...Leke |
| 3 | Zëvendës drejtor<br>Shef shërbimi i kujdesit parësor<br>Shef shërbimi urgjence<br>Shef shërbimi i mjeksisë familjare | 10050 | 2% | | 27200 | | Nga..deri ...Leke |
| 4 | Shef shërbimi i higjenës<br>Shef shërbimi i epidemiologjisë | 10050 | 2% | | 27200 | 9000 | Nga..deri ...Leke |
| 5 | Shef shërbimi stomatologjik | 10050 | 2% | | 27200 | 3300 | Nga..deri ...Leke |
| 6 | Shef sektori<br>Shef reparti<br>Përgjegjës poliklinike<br>Shef kabineti<br>Shef/përgjegjës laboratori<br>Përgjegjës dispancerie | 10050 | 2% | | 21900 | | Nga..deri ...Leke |
| 7 | Specialist i lartë në higjenë<br>Specialist i lartë në epidemiologji | 10050 | 2% | | 21900 | 7000 | Nga..deri ...Leke |
| 8 | Epidemiolog<br>Higjenist | 10050 | 2% | | 21900 | 8000 | Nga..deri ...Leke |
| 9 | Inspektor stomatolog | 10050 | 2% | | 21900 | 1100 | Nga..deri ...Leke |
| 10 | Shef reparti/laboratori në higjenë | 10050 | 2% | | 21900 | 9000 | Nga..deri ...Leke |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shef reparti/laboratori në epidemiologji | | | | | | |
| 11 | Përgjegjës i shërbimeve të shëndetit mendor | 10050 | 2% | | 21900 | 5000 | Nga..deri ...Leke |
| 12 | Mjek<br>Stomatolog<br>Inxhinier elektrik<br>Kimist<br>Veteriner<br>Mikrobiolog | 10050 | 2% | | 18500 | | Nga..deri ...Leke |
| 13 | Mjek ftizioterapeut<br>Mjek kirurg<br>Mjek ortoped<br>Mjek pneumoftiziatër | 10050 | 2% | | 18500 | 1100 | Nga..deri ...Leke |
| 14 | Mjek radiolog<br>Mjek hematolog<br>Mjek onkolog | 10050 | 2% | | 18500 | 1600 | Nga..deri ...Leke |
| 15 | Mjek,psikolog,punonjës socialë që punojnë në shërbimet e shëndetit mendor | 10050 | 2% | | 18500 | 5000 | Nga..deri ...Leke |
| 16 | Pergjegjes zyre<br>Revizor<br>Inspektor | 10050 | 2% | | 17160 | 1100 | Nga..deri ...Leke |
| 17 | Specialist me arsim të lartë | 10050 | 2% | | 17160 | | Nga..deri ...Leke |
| 18 | Specialist i lartë promocioni | 10050 | 2% | | 16000 | 4000 | |

**LIDHJA I**
**(KREU 1.3)**

**Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Spitalet e rretheve, Qendrën e Mirërritjes Zhvillimit dhe Reabilitimit të Fëmijëve**

| | | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | **EMËRTIMI** | **Paga e Grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa per Kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHKP)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Drejtor | 10050 | 2% | 0 | 55000 | | Nga..deri ...Leke |
| 2 | Shef shërbimi në anatomopatologji | 10050 | 2% | 0 | 35300 | 3500 | Nga..deri ...Leke |
| 3 | Zëvendës drejtor<br>Shef shërbimi | 10050 | 2% | 0 | 27200 | | Nga..deri ...Leke |
| 4 | Shef shërbimi reanimacioni<br>Shef shërbimi infektiv<br>Shef shërbimi obsetrik gjinekologjik<br>Shef shërbimi kirurgji<br>Shef shërbimi ortopedi | 10050 | 2% | 0 | 27200 | 1100 | Nga..deri ...Leke |
| 5 | Shef shërbimi radiologji<br>Shef shërbimi neuropsikiatri | 10050 | 2% | 0 | 27200 | 1600 | Nga..deri ...Leke |
| 6 | Shef shërbimi psikiatri | 10050 | 2% | 0 | 27200 | 5000 | Nga..deri ...Leke |
| 7 | Shef reparti/klinike<br>Përgjegjës/shef kabineti<br>Përgjegjës/shef laboratori (fizioterapi) | 10050 | 2% | 0 | 21900 | | Nga..deri ...Leke |
| 8 | Shef I bankës së gjakut<br>Shef reparti radiologjie<br>Shef reparti pneumoftiziatri | 10050 | 2% | 0 | 21900 | 1100 | Nga..deri ...Leke |
| 9 | Shef reparti/klinike psikatri | 10050 | 2% | 0 | 21900 | 5000 | Nga..deri ...Leke |
| 10 | Përgjegjës laboratori klinik biokimik | 10050 | 2% | 0 | 21900 | 2500 | Nga..deri ...Leke |
| 11 | Përgjegjës/shef reparti anatomopatologji | 10050 | 2% | 0 | 21900 | 3700 | Nga..deri ...Leke |
| 12 | Mjek<br>Stomatolog<br>Biolog | 10050 | 2% | 0 | 18500 | | Nga..deri ...Leke |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kimist<br>Fizikant<br>Shef sektori<br>Përgjegjës zyre | | | | | | |
| 13 | Mjek infeksionist<br>Mjek urgjence<br>Mjek laboratori<br>Kimist, fizikant laboratori<br>Kimist në shërbim gjaku | 10050 | 2% | 0 | 18500 | 600 | Nga..deri ...Leke |
| 14 | Mjek onkolog<br>Mjek kirurg ( specialitete të ndryshme kirurgjikale)<br>Mjek hematolog<br>Mjek I bankës së gjakut<br>Mjek obsetër gjinekolog<br>Mjek pneumoftiziatër<br>Mjek fizioterapeut | 10050 | 2% | 0 | 18500 | 1100 | Nga..deri ...Leke |
| 15 | Mjek radiolog | 10050 | 2% | 0 | 18500 | 1600 | Nga..deri ...Leke |
| 16 | Mjek higjenist<br>Farmacist | 10050 | 2% | 0 | 18500 | 2500 | Nga..deri ...Leke |
| 17 | Mjek anatomopatolog<br>Mjek anestezist reanimator | 10050 | 2% | 0 | 18500 | 3700 | Nga..deri ...Leke |
| 18 | Mjek,psikolog,punonjës socialë që punojnë në psikiatri | 10050 | 2% | 0 | 18500 | 5000 | Nga..deri ...Leke |
| 19 | Specialist i lartë | 10050 | 2% | 0 | 14700 | | Nga..deri ...Leke |

## LIDHJA I

**(Kreu 1.4)**

**Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Kontrollit të Barnave**

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA MUJORE** | | | | | |
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **EMËRTIMI** | **Paga e Grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për Kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte pune (SHKP)** | **Totali** |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| 1 | Drejtor | 10050 | 2% | 0 | 65000 | | Nga..deri ...Leke |
| 2 | Zëvendës drejtor | 10050 | 2% | 0 | 55000 | | Nga..deri ...Leke |
| 3 | Shef sektori | 10050 | 2% | 0 | 49000 | | Nga..deri ...Leke |
| 4 | Shef sektori | 10050 | 2% | 0 | 37450 | | Nga..deri ...Leke |
| 5 | Farmacist<br>Analist | 10050 | 2% | 0 | 37450 | 4000 | Nga..deri ...Leke |
| 6 | Farmacist inspektor për kontrollin farmaceutik | 10050 | 2% | 0 | 37450 | 5000 | Nga..deri ...Leke |
| 7 | Specialist i lartë | 10050 | 2% | 0 | 18500 | | Nga..deri ...Leke |

**LIDHJA 1**
**(Kreu 1.5)**

**Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën e shërbimeve Mjeksore**

| | | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | EMËRTIMI | Paga e Grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për Kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) | Shtesa për kushte pune (SHKP) | Totali |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| 1 | Drejtor | 10050 | 2% | 0 | 37400 | 2200 | Nga..deri ...Leke |
| 2 | Shef sektori | 10050 | 2% | 0 | 27200 | | Nga..deri ...Leke |
| 3 | Mjek.Stomatolog | 10050 | 2% | 0 | 21900 | | Nga..deri ...Leke |

**LIDHJA 1**
**(Kreu 1.6)**

**Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën e Inxhinierisë Biomjeksore**

| | | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | EMËRTIMI | Paga e Grupit (PG) | Shtesa per vjetersi (SHV) | Shtesa per Kualifikim (SHK) | Shtesa per pozicion (SHP) | Shtesa per kushte pune (SHKP) | Totali |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| 1 | Drejtor | 10050 | 2% | 0 | 35300 | | Nga..deri ...Leke |
| 2 | Shef sektori<br>Përgjegjës i zyrës teknike<br>Përgjegjës reparti | 10050 | 2% | 0 | 17160 | | Nga..deri ...Leke |
| 3 | Specialist i lartë | 10050 | 2% | 0 | 14700 | | Nga..deri ...Leke |

**LIDHJA 1**
**(KREU 1.7)**

**Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën e Transfuzionit të Gjakut**

| | | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | **EMËRTIMI** | **Paga e Grupit (PG)** | **Shtesa per vjetersi (SHV)** | **Shtesa per Kualifikim (SHK)** | **Shtesa per pozicion (SHP)** | **Shtesa per kushte pune (SHKP)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Drejtor | 10050 | 2% | 0 | 55000 | | Nga..deri ...Leke |
| 2 | Zëvendës drejtor | 10050 | 2% | 0 | 27200 | | Nga..deri ...Leke |
| 3 | Përgjegjës i sektorit të laboratorëve. Shef i bankës së gjakut. | 10050 | 2% | 0 | 21900 | 2500 | Nga..deri ...Leke |
| 4 | Shef sektori | 10050 | 2% | 0 | 21900 | | Nga..deri ...Leke |
| 5 | Mjek,Kimist | 10050 | 2% | 0 | 21900 | 1100 | Nga..deri ...Leke |
| 6 | Specialist i lartë | 10050 | 2% | 0 | 17160 | | Nga..deri ...Leke |

**LIDHJA I**

**(KREU 1.8)**

**Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Njësinë e Transportit Mjeksor me Helikopterë**

| | | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | EMERTIMI | Paga e Grupit (PG) | Shtesa për vjetërsi (SHV) | Shtesa për Kualifikim (SHK) | Shtesa për pozicion (SHP) | Shtesa për kushte pune (SHKP) | Totali |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| 1 | Shef i Njësisë | 10050 | 2% | 0 | 84000 | 8000 | Nga..deri ...Leke |
| 2 | Pilot | 10050 | 2% | 0 | 65000 | 8000 | Nga..deri ...Leke |
| 3 | Teknik helikopteri | 10050 | 2% | 0 | 61500 | | Nga..deri ...Leke |
| 4 | Shef sektori | 10050 | 2% | 0 | 27200 | | Nga..deri ...Leke |
| 5 | Specialist i lartë | 10050 | 2% | 0 | 18500 | | Nga..deri ...Leke |

**LIDHJA 1**

**(Kreu 1.9)**

**Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Cilesisë , Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.**

| | | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | PAGA INDIVIDUALE | | | SHTESA E POZICIONIT | | |
| | EMERTIMI | Paga e Grupit (PG) | Shtesa per vjetersi (SHV) | Shtesa per Kualifikim (SHK) | Shtesa per pozicion (SHP) | Shtesa per kushte pune (SHKP) | Totali |
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | |
| 1 | Drejtor | 10050 | 2% | 0 | 84000 | | Nga..deri ...Leke |
| 2 | Shef sektori | 10050 | 2% | 0 | 49000 | | Nga..deri ...Leke |
| 3 | Specialist i lartë | 10050 | 2% | 0 | 37450 | | Nga..deri ...Leke |

## VENDIM
## Nr.463, datë 18.7.2007

## PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE NË KASKADËN E LUMIT DEVOLL, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3 shkronja "b", të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve, në kaskadën e lumit Devoll, nga kuota 805-100 m mbi nivelin e detit, përfshirë edhe ndërtimin e hidrocentralit të Banjës, është

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 10 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “EVN” sh.a.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare**
**ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”,
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

| | | |
|---|---|---|
| **i.** | **PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)............** | **1300** |
| **ii.** | **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT……………...........** | **500** |
| **iii.** | **PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË………………………………………….........................................** | **1000** |
| **iv.** | **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR………………….** | **800** |
| **v.** | **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET…………………......…......** | **500** |
| **vi.** | **PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)………………………………………………………………………………** | **1000** |
| **vii.** | **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE……..........** | **500** |

## TREGUES LEGJISLACIONI

| | | |
|---|---|---|
| **1** | **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)…......…........** | **1000** |
| **2** | **TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)…......…......** | **500** |
| **3** | **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)…………….…......** | **1000** |
| **4** | **TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)…………….…......** | **500** |

Hyri në shtyp më 2.8.2007
Doli nga shtypi më 2.8.2007

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 3500 copë | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2007

Çmimi 24 lekë